

## **Mbi Kriteret për Përcaktimin e Aksesit në Hapësirat e Depozitimit të Gazit Natyror**

### **I. Dispozita të përgjithshme**

Udhëzimi mbi Kriteret për Përcaktimin e Aksesit në Hapësirat e Depozitimit të Gazit Natyror (këtu dhe më poshtë Udhëzimi) përcakton kriteret sipas të cilave vendoset regjimi i negociuar ose i rregulluar i aksesit për çdo hapësirë depozitimi të gazit natyror në Shqipëri (këtu dhe më poshtë Kriteret).

Qëllimi i këtij Udhëzimi është të sigurojë një treg transparent dhe që funksionon mirë për depozitimin e Gazit Natyror në Shqipëri, po ashtu të ofrojë fleksibilitet dhe mjete për sigurinë e furnizimit për përdoruesit e rrjetit në mënyrë që të furnizojnë konsumatorët e tyre në Shqipëri, gjë që do të kontribuojë në një treg të integruar dhe konkurses të gazit natyror në Komunitetin e Energjisë.

Në këtë Udhëzim të gjitha termat janë përdorur sipas kuptimit të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” (këtu dhe më poshtë: Ligji).

### **II. Qëllimi i aplikimit**

Ky Udhëzim do të aplikohet për depozitimin e gazit nga Operatorët që do të operojnë në Shqipëri sipas Ligjit në rastet kur është teknikisht dhe/ose ekonomikisht e nevojshme për të siguruar akses eficient për furnizimin e konsumatorëve.

Bazuar në këtë Udhëzim, Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë ERE) duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar akses jo-diskriminues në rastet kur aplikohet regjimi i negociuar i aksesit, ose për të miratuar tarifatat për akses në rastet kur aplikohet regjimi i rregulluar i aksesit.

Bazuar në këtë Udhëzim dhe raportit të miratuar nga ERE sipas Paragrafit 15, ERE do të miratojë regjimin e rregulluar ose atë të negociuar të aksesit, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese për çdo hapësirë depozitimi.

### III. Kriteret për të përcaktuar regjimin e aksesit

ERE do të përgatisë një raport duke iu referuar paragrafit 15 të këtij Udhëzimi bazuar në Kriterin e specifikuar këtu. Bazuar në këtë raport ERE do të vendosë për regjimin e aksesit në bazë të konkluzioneve të Raportit dhe do të justifikojë vendimin e saj.

Kriteret për përcaktimin e rregjimit të aksesit nga ERE përfshijnë si më poshtë:

- Kriteret në lidhje me *konkurencën me burime të tjera të fleksibilitetit, cmimet e depozitimit dhe rolin e depozitimit në treg*, përgjigjet pozitive të të cilit duhet të favorizojnë regjimin e rregulluar të aksesit;
- Kriteret në lidhje me *kushtet e tregut për depozitimin dhe sigurinë e furnizimit* përgjigjet pozitive të të cilit duhet të favorizojnë regjimin e rregulluar të aksesit.

Raporti i referuar në paragrafin 15 të Udhëzimit duhet të përmbajë një algoritëm për të vlerësuar rëndësinë e Krieteve të përcaktuara si më poshtë:

#### a) *Kriteri në lidhje me konkurencën*

Në lidhje me rolin e depozitimit në një treg fleksibel, ERE duhet të vlerësojë:

- Nëse hapësira e depozitimit është në gjendje që të përballojë pikun sezonal të dimrit;
- Nëse ekziston në treg konkurenca efektive midis hapësirave të depozitimit ose midis hapësirave të depozitimit dhe shërbimeve të tjera fleksibël (siç janë kapaciteti i importit, fleksibiliteti në prodhim, kapaciteti i importit të GNL, kontratat e importit, tregtimi në pikat/qendrat e shkëmbimit të gazit);
- Në rast se nuk ka konkurrencë efektive në vend, a ka ndonjë perspektivë të mundshme që në një kohë të shkurtër që kjo konkurrencë të ndodhë, së bashku me zhvillimin e presioneve konkurruese midis hapësirave të depozitimit ose midis hapësirave të depozitimit dhe burimeve të tjera fleksibël;
- Nëse ka një perspektivë të mundshme që një hapësirë depozitimi të jetë në konkurrencë me hapësirat e depozitimi të vendeve fqinjë, veçanërisht, me ato të Evropës Jug-Lindore; dhe

- Nëse përgjigja e pyetjes në paragrafin 10.4 është *PO*, a është regjimi që aplikohet për hapësirat e mundshme konkurruese të depozitimit në Europen Jug-Lindore një regjim aksesi i negociueshëm.

*b) Kriteri në lidhje me çmimet e depozitimit*

ERE duhet të vlerësojë, në rastet kur tarifa e depozitimit për një hapësirë është e rregulluar:

- Nëse humbjet e Operatorit të Sistemit të Depozitimit kanë ndodhur për shkak të çmimeve të ulura; dhe
- Nëse tarifa e depozitimit ishte një dekurajim për investimet në një hapësirë depozitimi.

*c) Roli i depozitimit në tregun e gazit*

ERE duhet të vlerësojë rolin e depozitimit për tregjet e gazit natyror në Shqipëri dhe Evropë dhe veçanërisht:

- Nëse numri dhe madhësia e hapësirave të depozitimit në Shqipëri është në proporcion me numrin dhe madhësinë e hapësirave të depozitimit në vendet e tjera të Evropës;
- Nëse madhësia e kapacitetit total të depozitimit është në mënyrë proporcionale e lartë me kërkesën vjetore të Shqipërisë për gaz;
- Nëse operatori i depozitimit mund të përshtasë shërbime të tjera sipas zhvillimit të tregut në Shqipëri dhe tregjeve të vendeve fqinje; dhe
- Nëse kushtet gjeologjike të vendit janë të favorshme për zhvillimin e mundshëm të hapësirave të tjera të depozitimit.

*d) Kriteri që lidhet me kushtet e tregut për depozitimin*

ERE duhet të vlerësojë aksesin efektiv tek depozitimet, veçanërisht:

- Nëse kapaciteti rezervohet më shumë nga një apo nga disa kompani të mëdha;
- Nëse ka një proporcion të lartë rezervimi për kapacitetin e hapësirave në një afat të shkurtër;
- Nëse ka një sasi relativisht të vogël të kapacitetit në dispozicion; dhe
- Nëse kapaciteti në dispozicion jepet në mënyrë diskriminuese.

*e) Roli i depozitimit për sigurinë e furnizimit*

ERE duhet të vlerësojë rolin e ndikimit të masave që kanë të bëjnë me sigurinë e furnizimit në lidhje me depozitimet dhe veçanërisht:

- Nëse kapaciteti i depozituar është ndarë si një rezervë strategjike apo ka një funksion të ngjashëm për nevojat e konsumatorëve Shqiptarë; dhe
- Nëse detyrimet e vendosura për furnizuesit që kanë lidhje me sigurinë e furnizimit përballojnë depozitimin e një pjese proporcionalisht të madhe në depozitimet e tyre të gazit.

#### **IV. Përcaktimi i regjimit të aksesit**

ERE duhet të publikojë rezultatet e vlerësimit të Kritereve në një raport të përmbledhur. Fillimisht raporti duhet të përgatitet dhe publikohet nga ERE në datën e përcaktuar nga ERE.

ERE duhet të zgjedhë midis regjimit të aksesit të negociuar ose regjimit të aksesit të rregulluar për depozitimet, sipas konkluzioneve të Raportit.

Operatorët e sistemit të depozitimit duhet të aplikojnë regjimin për çdo hapësirë depozitimi si vendoset nga ERE dhe të publikojnë vendimin në faqen e tyre të internetit.

Çdo operator i sistemit për depozitimin është i detyruar të lejojë akses tek hapësirat e depozitimit në përputhje me kodin përkatës të depozitimit, pavarësisht regjimit të aksesit që ka aplikuar.

## **V. Monitorimi i aplikimit të Kriteve**

ERE duhet të monitorojë aplikimin e duhur të Kriteve nga operatorët e sistemit të depozitimit. ERE mund të nxjerrë udhëzime për operatorin e sistemit të depozitimit në rast se është negociuar regjimi i aksesit që do të aplikohet.

Bazuar në rezultatet e monitorimit, ERE mund të dalë në përfundimin se është i nevojshëm ndryshimi i regjimit të aksesit ose mund të vendosë që të ndryshojë regjimin e aksesit të aplikuar.

ERE duhet të justifikojë vendimin për ndryshimin e regjimit të aplikuar për aksesin dhe ta publikojë atë në faqen e internetit.

Asnjë gjë në këto Udhëzime nuk duhet të ndalojë ERE nga detyrat dhe kompetencat e saj në lidhje me monitorimin dhe rishikimin e kushteve të aksesit për depozitimin.

## **VI. Dispozitat përfundimtare**

ERE duhet të rishikojë Kriteret të paktën cdo tre (3) vjet, duke marrë parasysh rezultatit nga operatorët e sistemit të depozitimit, përdoruesit e sistemit të depozitimit dhe treguesit.

Mbas miratimit dhe publikimit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë Udhëzimi dhe Kriteret e vlerësimit të kryer nga ERE duket të publikohen në faqen e internetit të ERE.

Interpretimi i këtij udhëzimi duhet të sigurohet dhe të njoftohet publikisht nga ERE sipas rregullave proceduriale.

Personat të cilët nuk zbatojnë këto udhëzime ose vendimet përkatëse të miratuara nga ERE janë përgjegjës sipas Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.